DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

A-489066
VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Përfundon pa marrëveshje takimi Kurti–Hamza, mbeten të hapura çështja e Speciales dhe presidentit - Informohu siç duhet
ADRESA	`https://radar.al/perfundon-pa-marreveshje-takimi-kurti-hamza-mbeten-te-hapura-ceshtja-e-speciales-dhe-presidentit/`
BURIMI	radar.al
GJENDJA	online

KOHA

KAPUR NGA NE	2 tetor 2026, 18:55:34 UTC *Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.*
DEKLARUAR NGA PORTALI	2 tetor 2026, 18:20:00 UTC *Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.*

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	`22447462f60fee041b729975139a61e4e6178b4065bbbb73ed32bf8c0c4f9c31`
TEKSTI	`13b391153eda78b092de537c8bb6d9c27cdfba207ff6f6144db2651f03f66787`
PAMJA	`5aa695400704d09f365e3213934d009aa84471e38fc6c8ce854821bdc8def69d`

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	`50dc5b1be503d162a96516eca7c171a1a4f4f43f185cd73648bb6e714282ebcb`
E MËPARSHMJA	–
RRËNJA MERKLE	–
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende *Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.*

SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/50dc5b1be503d162a96516eca7c171a1a4f4f43f185cd73648bb6e714282ebcb`

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

KOSOVË

Përfundon pa marrëveshje takimi Kurti–Hamza, mbeten të hapura çështja e Speciales dhe presidentit

OCTOBER 2, 2026

Ka përfunduar pa marrëveshje takimi mes kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, dhe kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës, Bedri Hamza. Takimi, i zhvilluar më 2 tetor, zgjati rreth dy orë dhe në fokus kishte situatën politike, çështjen e Gjykatës Speciale në Hagë dhe zgjedhjen e presidentit të Kosovës.

Pas takimit, Hamza tha se palët diskutuan për procesin gjyqësor në Hagë, ndryshimet e propozuara në Ligjin për Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe zgjedhjen e presidentit.

"Biseduam për situatën aktuale politike që ka të bëjë me procesin në Hagë, me nevojën që ligji të procedohet dhe aprovohet në Kuvend, dhe tema zgjedhja e presidentit", deklaroi Hamza.

Kreu i PDK-së theksoi se për partinë e tij prioritet mbetet miratimi i ndryshimeve në ligjin për Dhomat e Specializuara, ndërsa diskutimi për presidentin, sipas tij, mund të vijojë pas përfundimit të këtij procesi.

"Është nevojë dhe domosdoshmëri aprovimi i ligjit për Specialen dhe pastaj ne jemi të hapur të diskutojmë për presidentin", tha Hamza.

Ai konfirmoi se deri tani nuk është arritur ndonjë marrëveshje me Kurtin për temat e diskutuara, por la të hapur mundësinë e takimeve të tjera.

"Nuk ka marrëveshje deri më tani për temat për të cilat kemi biseduar. Është e mundshme që kemi takime edhe ditëve në vijim", u shpreh ai.

Takimi ishte zhvilluar në një kohë kur afati për zgjedhjen e presidentit të ri po afron. Kuvendi i Kosovës ka kohë deri më 6 tetor për të zgjedhur presidentin. Nëse zgjedhja nuk realizohet brenda afatit kushtetues, Kosova shkon në zgjedhje të reja.

Çështja e ndryshimeve në Ligjin për Dhomat e Specializuara ka qenë prej ditësh një nga temat kryesore në diskutimet mes partive politike. PDK-ja ka lidhur mbështetjen për procesin e zgjedhjes së presidentit me procedimin e këtyre ndryshimeve, ndërsa Qeveria ka qenë në pritje të opinionit ligjor nga Ministria e Drejtësisë.

kurti

SHARE.

Demo

Postimet e reja

Nafta nis të bjerë pas vendimit për lirimin e 10...
OCTOBER 2, 2026

Përfundon pa marrëveshje takimi Kurti...
OCTOBER 2, 2026

Lituania teston sistemin ukrainas "Sky Fortress"...
OCTOBER 2, 2026

VIDEO/ Përshkallëzohen protestat studentore në...
OCTOBER 2, 2026

Mos e humb

EKONOMI | OCTOBER 2, 2026

Çfarë pritet? Ilegaliteti "ngrin" prej 10 ditësh në Shqipëri! Mbyllen bastet dhe Call Centerat, bien transaksionet me Kriptomonedha

Prej gati dhjetë ditësh, aktiviteti i basteve të paligjshme dhe i call center-ave ilegalë në...

Dosja/ Biznesmeni Meqemeja i dha Ahmetajt 140 mijë euro! SPAK: Shpërblim për Inceneratorin e Fierit përmes shitjeve fiktive

ALERT në Sllloveni për VIPA Flips të Kosovës, kanë përmbajtje të alergjenësh. Produkti hiqet nga tregu

Kreditorët te dera, gjykata në kërkim të "Top Fruits" të Ejup Ahmetit dhe Marin Gjonajt: Paraqituni në gjyq

Na ndiq

Facebook Instagram



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.